Takimi Vjetor Ministror i III-te i SEETAC & Forumi i Infrastructures (SEEIF):

Perfaqesues Ministror, Komisioni Evropian dhe Institucione Nderkombetare Financiare u takuan ne Athine ne 22 Maj 2012, per te diskutuar mbi lidhjen e sistemit te transportit te Evropes Jug-Lindore me ate te Bashkimit Evropian.

Perfaqesues te Ministrive te Transportit dhe Infrastruktures te Shqiperise, Austrise, Bosnje- Herzegovines, Bullgarise, Kroacise, Greqise, Hungarise, Italise, Malit te ZI, Rumanise, Serbise, Sllovenise, Ukraines (Vende partnere te SEETAC), Komisionit Evropian (Drejtoria e Pergjithshme per Zgjerimin dhe Drejtoria e pergjithshme per Levizshmerine dhe Transportin), Banka Evropiane e Investimeve, Organizata Rajonale (RCC and SEETO) dhe operatore te transpotit (Unioni Nderkombetar i Rrugeve, Trainose, Organizata e Hekurudhave te Greqise dhe Autoriteti Grek Rregullator i Hekurudhave) u mblodhen ne Athine, ne 22 Maj 2012, per te diskutuar mbi koordinimin e investimeve ne infrastukturen e transportit dhe organizimin me te mire te planifikimit ne transport.

Konferenca e III-te Ministrore e SEETAC u hap nga Z. Aristeides Bourdaras, Sekretar i Pergjithshem Ministrise se Infrastruktures, Transportit dhe e Rrjeteve, te Greqise dhe nga Ambasadori Gerhard Pfanzelter, Sekretar I Pergjithshem i Inisjatives se Europes Qendrore (CEI) i cili theksoi rendesine e sektorit te transportit te Evropes Jug-Lindore.

“Projekti SEETAC perfaqson nje inisjative pararoje per CEI per vet faktin se ka per qellim te analizoje mundesine e integrimit te sistemit te transportit te Ballkanit Perendimor ne sistemin e transportit te Bashkimit Evropian ne menyre qe te siguroj vijueshmerine e transportit dhe zhvillimin e infrastruktures ne zonen Evropiane dhe me tej, duke cuar keshtu ne rritjen e konkurrueshmerise dhe zhvillim ekonomik me synimin perfundimtar integrimin e vendeve te Ballkanit Perendimor ne nje treg te vetem Evropian” tha Ambasadori Pfanzelter.

Perfaqsuesit e Ministrive te Transportit te SEETAC paten mundesi te diskutonin prioritetet dhe programet e tyre te investimeve, rendesine e planifikimit dhe te koordinimit ne nivel rajonal si dhe te nenvizonin veshtiresite ne implementimin e reformave. Takimi u fokusua gjithashtu ne debatin aktual mbi Rregulloren e propozuar per Rrjetin Evropian te Transportit (TEN-T) dhe ne politiken e transportit te BE-se per Evropen Jug-Lindore.

Z. Carlo Fortuna, Menaxher i SEETAC duke prezantuar arritjet kryesore te SEETAC vuri ne dukje nevojen per te rivleresuar rajonin e Evropes Jug-Lindore (SEE) si nje element kyc ne sistemin e transportit te BE-se dhe rendesine e kapercimit te ciklit viskoz te masave

shtrenguese dhe te mungeses se investimeve ne infrastrukture nepermjet marrjes se masave konktrete, koordinim me te mire rajonal dhe perzgjedhjes se kujdesshme te projekteve prioritare.

Pjesmarres te tjere, perfshire Zevendes Ministrin e Puneve Publike dhe Transportit te Shqiperise dhe Keshilltarin e Ministrit te Transportit te Bosnje- Herzegovines theksuan rolin strategjik te sektorit te transportit per ekonomine e Ballkanit Perendimor.

Komisioni Evropian – Drejtoria e Pergjithshme per Levizshmerine dhe Transportin theksoi rendesine e projektit SEETAC, ne kontributin e dhene ne procesin e rishkimit te TEN-T, ne argumentat e dhena per zgjerimin e TEN-T ne Ballkanin Perendimor dhe punen e bere ne sinergji me projektet prioritare te SEETOs.

Takimi Ministror u parapri nga **Forumi i Infrastruktures** i cili u fokusua ne koordinimin e prioriteteve, ne investimet e transportit ne rajon, ne reformat administrative si dhe ne pengesat ne pikat e kalimit kufitar. Ne vecanti pjesmarresit paten mundesine te diskutonin per koordinimin e planifikimit te investimeve prioritare ne BE dhe ne vendet fqinje, me fokus ne vendet e Ballkanit Jug-Lindor (SEE). Forumi kishte per qellim gjithashtu qe te siguronte te dhena te vlefshme per Takimin e III-te Ministror te SEETAC per te kontribuar ne menyre effektive ne debatin per integrimin e Ballkanit Perendimor ne sistemin e transportit te BE-se.

Konferenca Ministrore e Transportit dhe Forumi i Infrastruktures u organizuan nga Ministria e Infrastruktures, Transportit dhe e Rrjeteve, e Greqise dhe Universiteti Aristotle i Selanikut, ne bashkepunim me Inisjativen e Europes Qendrore (CEI).

Projekti SEETAC eshte bashkefinancim i Bashkimit Evropian nepermjet Programit te Bashkepunimit te Evropes Jug-Lindore me nje buxhet total prej 2,38 million Euro. Qellimi i projektit eshte ndertimi i nje kuadri efektiv dhe te koordinuar per Aksin e Transportit te Evropes Jug-Lindore me qellim nxitjen e bashkepunimit institucional ndermjet strukturave te Korridoreve Pan Evropiane dhe Shteteve Anetare. Synimi eshte te arrihen objektivat e BE-se per (i) transparence dhe besueshmeri informacioni (ii) kuader institucional te harmonizuar dhe eficient dhe (iii) implementim i menjehershem i projekteve prioritare te transportit.

Konferenca finale e projektit SEETAC do te organizohet nga Ministria e Infrastruktures dhe e Planifikimit Hapsinor e Sllovenise, ne fund te Gushtit 2012.

Per me shume informacion www.seetac.eu